



THIRRJE

Për shprehje të interesit për monitorim - vëzhgim të Zgjedhjeve Studentore të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), 2018.

- I. Në bazë të nenit 10 të Rregullores për Zgjedhjet Studentore 2018, UShAF u bënë thirrje të gjitha institucioneve, organizatave dhe palëve të tjera për shprehje të interesit për monitorim të gjithë procesit të Zgjedhjeve Studentore të shpallura me vendimin e Këshillit Drejtues të UShAF, të cilat do të mbahen me 18.09.2018.
- II. Shprehja e interesit për monitorim të zgjedhjeve nga institucionet, organizatat dhe palët e tjera, bëhet në formë të shkruar dhe dorëzohet në Zyren 009 të UShAF. Aplikimi për monitorim duhet të përmbajë: emrin e institucionit; Dëshmi se është person juridik; Emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar për monitorim; Numrin kontaktues dhe e-mail adresën.
- III. Në pajtim me nenin 15 të Rregullores për Zgjedhjet Studentore, secila organizatë studentore që kualifikohet për pjesëmarrje në Zgjedhjet Studentore dhe e cila nuk është e përfaqësuar në Komisionin Zgjedhor, ka të drejtë të nominoj një vëzhgues në Komisionin Zgjedhor.

Aplikimi për monitorim - vëzhgim të Zgjedhjeve Studentore bëhet me 03.09.2018, kurse certifikimi do të bëhet nga KQZ me 04.09.2018.

UShAF është i përkushtuar për një proces të rregullt zgjedhor, transparent dhe korrekt.

Ju mirëpresim!

